



# The British School of Kosovo

## Shpërblimet dhe masat ndëshkuese

### **I. Hyrje**

Në pajtueshmëri me Kodin e Mirësjelljes & Rregulloren e Shkollës, i gjithë stafi është përgjegjës për mirësjelljen dhe disiplinën e nxënësve të tyre. Ata duhet të përdorin strategji dhe masa ndëshkuese efektive për të mbajtur rend në shkollë. Në rastet kur shfaqet ndonjë sjellje e papranueshme apo mosdisiplinë, stafi i shkollës duhet që gjithmonë të:

- Veprojnë në mënyrë të paanshme;
- Krijojë marrëdhënie të respektueshme me nxënësit;
- Merret shpejtë dhe personalisht në rast të sjelljes së keqe apo mosdisiplinës nga ana e nxënësve;
- Aplikojë qasje të pranueshme.

Për të promovuar vlera pozitive në shkollë, stafi duhet të përdorë edhe masa ndëshkuese, por edhe lëvdata / shpërblime, dhe çdo masë e ndërmarrë duhet të shërbejë për inkurajimin e nxënësve.

Çdo pjesëtar i shkollës ka për detyrë që të kujdeset që në shkollë të mbizotërojë rendi dhe qetësia.

## **I. Shpërblimet për nxënësit**

*Lëvdatat dhe inkurajimet shpesh janë shpërblim i mjaftueshëm për një fëmijë !*

‘‘Pikët e Shkollës’’ u jepen fëmijëve kur kanë sjellje të mira dhe kur punojnë me zell. Në secilën klasë, çdo nxënës që ka mbledhur pikë më së shumti, i jepet një certifikatë.

Mësimdhënësi mund të përzgjedh, çdo javë, nga një nxënës i cili / e cila shpërblehet me kategorinë ‘‘fëmija i artë’’.

## **II. Masat ndëshkuese**

*Është detyrë dhe përgjegjësi e secilit mësimdhënësi që të zgjidhë shkeljen / shkeljet e rregullave në instancën e parë. Marrja e masave ndëshkuese duhet të bëhet me kujdes, me urtësi dhe të jetë e menduar mirë. Ato duhet të jenë të paanshme, të përshtatshme dhe meritore.*

Çdo nxënës në klasë duhet ta ketë të ngjitur në uniformë ‘‘kartën e semaforit’’. Fillimisht, të gjithë nxënësit, e kanë ‘‘kartën e semaforit’’ me ngjyrë të gjelbër. Në rast se nxënësi nuk mban disiplinë, mësimdhënësi ia ndërron kartën e gjelbër me atë të portokalltë. Por, nëse përsëri i njëjti nxënës vazhdon të ketë sjellje jo të mira, atëherë mësimdhënësi ka të drejtë t’ia heqë kartën me ngjyrë të portokollatë, dhe t’ia vendosë kartën me ngjyrë të kuqe. Mësimdhënësi i regjistron në regjistrin e vërejtjeve nxënësit që kanë të ngjitur kartën me ngjyrë të kuqe. Në anën tjetër, nxënësit të cilët gjatë tërë ditës arrijnë ta mbajnë kartën me ngjyrë të gjelbër, atyre u dhurohen nga 3 ‘‘pikë të shkollës’’. Në fillim të secilës ditë të re, të gjithë nxënësit marrin kartën e gjelbër.

## **III. Sjelljet e këqija dhe incidentet e vazhdueshme**

Në rastet kur një apo më shumë nxënës vazhdojnë ta prishin qetësinë në klasë dhe të kenë sjellje jo të mira, atëherë mësimdhënësi ka të drejtë të marrë masat si në vijim:

- Ta mbajë në konsultim nxënësin gjatë kohës së pushimit ose gjatë kohës së drekës për një kohë të caktuar;
- Ta nxjerrë nga klasa nxënësin dhe ta dërgojë në klasën tjetër, te mësimdhënësi tjetër;
- Ta dërgojë nxënësit te zëvendës drejtori ose te drejtori për tu shpjeguar për sjelljen që ka bërë;
- Ta mbajë nxënësin në shkollë deri në orën 17.00;
- T’i informojë prindërit e nxënësit për mosdisiplinë **të vazhdueshme**, dhe nëse është e nevojshme edhe të takohet me njërin nga prindërit.

Megjithatë, edhe kur të merren masat e lartpërmendura ndëshkuese, mësimitdhënësi ka për obligim që:

- Nxënësi të mos lejohet të qëndrojë jashtë klasës pa një mbikëqyrje;
- Të aranzhohet paraprakisht dhe të ketë marrëveshje me kolegun për dërgimin e nxënësit në klasën tjetër;
- Të dërgohet drejtpërdrejtë dhe të shoqërohet për te zëvendës drejtori apo drejtori. Nëse asnjëri prej tyre nuk janë në zyre, atëherë nxënësit kthehet në klasë;
- Nxënësi të mos lejohet të qëndrojë duke pritur në zyrën e zv.drejtorit / drejtorit.

Në rastet kur mësimitdhënësi kërkon takim me prindërit e nxënësit, atëherë domosdoshmërisht duhet të njoftohet zv.drejtori / drejtori. Mësimitdhënësi duhet të bëjë raport me shkrim për rrjedhën e takimit me prindin, dhe një kopje duhet t'ia dërgojë zv.drejtorit / drejtorit. Drejtori duhet të njoftohet për çdo veprim që ndërmer mësimitdhënësi në rastet e tilla.

Tek asnjë nxënës nuk duhet të aplikohet masa e ndëshkimit që nxënësi të nxirret nga klasa dhe të qëndrojë në korridor apo gjetiu pa mbikëqyrje.

#### **IV. Incidentet serioze të sjelljes së keqe**

Në raste të tilla, mësimitdhënësi duhet të përfshihet drejtpërdrejtë dhe menjëherë ta raportojë rastin te drejtori. Mësimitdhënësi dhe kujdestari i klasës duhet ta regjistrojnë rastin në databazë duke spjeguar hollësisht incidentin. Ndëshkimi i nxënësit, në këto raste, duhet të bëhet në konsultim me drejtorin. Gjithashtu, prindërit duhet të jenë të njoftuar për çdo veprim që ndërmerret nga ana e personelit të shkollës.

#### **V. Shpërblimet**

Të gjithë fëmijët duhet të vlerësohen për personalitetin dhe talentet e tyre. Kurdo që është e mundur, aspektet pozitive të fëmijëve duhet të vihen në pah, dhe çdo kritikë për ta duhet të jetë konstruktive. Kritikën duhet të ju jepet fëmijëve për t'ju rritur atyre ndjenjën e vetëbesimit, e jo që këto kritika të shërbejnë për dëshpërimin e tyre. Shpërblimet duhet të jepet më shpesh se sa masat ndëshkuese.

Shpërblimet duhet të shërbejnë për të:

- Lavdëruar arritjet në mësim;
- Lavdëruar sjelljen e mirë dhe veprimet e dobishme;
- Shpërblimet për përmirësimet në të dy fushat e lartpërmendura.

## Shpërblimet

Niveli	Shembull i sjelljes pozitive	Shpërblimi
NIVELI 1	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpyetje individuale në klasë (p.sh. kur jep përgjigje të sakta në klasë, kur i bën të gjitha detyrat)</li> </ul>	Regjistrohet në rubrikën e lëvdatave.
NIVELI 2	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpyetje të shquar individuale në klasë</li> <li>Punë që i tejkalon kërkesat</li> <li>Përpyetje individuale që i tejkalon pritjet e mësimdhënësit.</li> </ul>	Regjistrohet në rubrikën e lëvdatave. I dërgohet në shtëpi një "kartë e lavdërimit".
Niveli	Shembull i sjelljes pozitive	Shpërblimi
NIVELI 3	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësime domethënëse / sjellje shumë të mira dhe / ose rezultat shumë të mirë në fund të vitit</li> </ul>	Regjistrohet në rubrikën e lëvdatave. U dërgohet një letër në shtëpi prindërve të nxënësit (e nënshkruar nga kujdestari i klasës).
NIVELI 4	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpyetje të shquara afatgjata dhe rezultat shumë të mirë</li> </ul>	Nxënësit i jepet një certifikatë në ditën e dhënies së çmimeve.

*Masat ndëshkuese*

<b>Niveli</b>	<b>Shembull i sjelljes së keqe</b>	<b>Pasojat</b>
NIVELI 1	<p>Sjelljet e këqija, të nivelit të parë, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vonesa në orën mësimore;</li> <li>• Mosveshja e uniformës;</li> <li>• Harrimi i pajisjeve;</li> <li>• Bisedat e vazhdueshme me njëritjetrin;</li> <li>• Shqetësimi / pengimi i tjerëve</li> <li>• Bërtima;</li> <li>• Përdorimi i telefonit mobil dhe pajisjeve tjera elektronik.</li> </ul>	<p>Regjistrohet në regjistrin e vërrejteve</p> <p>(Vërejtja e parë me shkrim)</p>
NIVELI 2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dështimi i dytë për të përmirësuar gabimin sikur në Nivelin 1</li> <li>• Refuzimi për të respektuar udhëzimet</li> </ul>	<p>Regjistrohet në regjistrin e vërrejteve.</p> <p>(Vërejtja e dytë me shkrim)</p>
<b>Niveli</b>	<b>Shembull i sjelljes së keqe</b>	<b>Pasojat</b>
NIVELI 3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kur nxënësi qortohet nga dy mësues</li> <li>• Kur nxënësi qortohet nga dy mësues për të njëjtën çështje</li> <li>• Probleme të vazhdueshme të qëndrimit</li> <li>• Mungesë konstante e punës</li> <li>• Dështim i vazhdueshëm për të respektuar udhëzimet</li> <li>• Vonesa të vazhdueshme</li> </ul>	<p>Regjistrohet në regjistrin e vërrejteve dhe u tregohet prindërve (Vërejtja e tretë me shkrim)</p> <p>Qëndron deri në ora 17.00 në shkollë.</p> <p>U dërgohet letër me shkrim prindërve, e nënshkruar nga ana e kujdestarit të klasës</p>
NIVELI 4	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjuhë abuzive (e përdorur me shokët / shoqet e klasës ose personelin e shkollës)</li> </ul>	<p>Njoftohet kujdestari i klasës</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Deklarime raciste</li> <li>• Vandalizëm</li> <li>• Agresion fizik ndaj shokëve / shoqeve të klasës</li> <li>• Dëmtimi serioz i inventarit / pajisjeve të shkollës</li> <li>• Bartja e gjërave si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Armë të ftohta dhe të zjarrta;</li> <li>2. Alkool;</li> <li>3. Drogë;</li> <li>4. Gjëra të vjedhura;</li> <li>5. Cigare;</li> <li>6. Imazhe pornografike.</li> </ol> </li> </ul> <p>Masat ndëshkuese në Nivelin 4 vendosen nga zv.drejtori / drejtori i shkollës dhe kujdestari i klasës.</p>	<p>2 orë qëndrim në shkollë në ditën e shtunë.</p> <p>Raport monitorues.</p> <p>Takim me prindërit.</p> <p>Përrjashtim i përkohshëm nga shkolla.</p> <p>Përrjshatim i përhershëm nga shkolla.</p>
--	--	---